REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 364/24
Datë/Datum. 03.05.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

OSHP: 2024/0364
Data e Vendimit: 02.05.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik "DEMOS" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me mjete dhe material higjienik për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-24-2417-1-1-1, iniciuar nga "KK PRIZREN", në cilësinë e autoritetit kontraktues, zv. Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Agim Sheqiri me datën: 02.05.2024, mori këtë::

VENDIM

I. Hedhet si e palejuar (parakohshme) ankesa e "DEMOS" SH.P.K. me nr. të protokollit 2024/0364, e datës 26.04.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete dhe material higjenik për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-24-2417-1-1-1, iniciuar nga "KK PRIZREN", nga cilësia e tij/saj si autoriteti kontraktues (AK).

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – "KK PRIZREN", që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete dhe material higjenik për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-24-2417-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

A R S Y E T I M

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 26.04.2024 ka pranuar ankesën me nr.0364/2024 nga "DEMOS" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me mjete dhe material higjenik për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-24-2417-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "KK PRIZREN"

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete dhe material higjenik për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-24-2417-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "KK PRIZREN" ndërsa me datë 15.03.2024 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë të AK. OE ankues "DEMOS" SH.P.K. nuk ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimit të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se: *"Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.* "Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se: *"Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji* lidhur me nenit 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e tillë hedhet si e pa lejuar në kuptimin si e parakohshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

AK -"KK PRIZREN" -, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete dhe material higjenik për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit" me numër të prokurimit 622-24-2417-1-1-1, megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK ,duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së. Po ashtu, zyra për financa, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Zv Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK – "KK PRIZREN"
1x1 OE - "DEMOS" SH.P.K.
1x1 Arhivës së OSHP-së;

Agim Sheqiri
Zv. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së